



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretur / Prijmljeno / Prodato / Received / Delivered	03.08.2022	viti / god / year
Organ / Njësia / Organ / Jedinica / Org. / Unit	4492/2022	Sasia / Kolicima / Quantity
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.		
Shtypja / Protok. / Appendix		



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.634/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën A.nr.634/2022 të datës 19.07.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë rruga

në Prishtinë, kundër Përgjigjes së datës 12.07.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 02.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundim Procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.634/2022 të datës 19.07.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme më datë 16.05.2022 ka shpallur njoftimin për publikimin e Konkursit me Nr. Reference: RN00009044 për pozitën Drejtor i Përgjithshëm 2 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, ku afati për aplikim ka qenë nga datës 15.06.2022 deri më datë 22.06.2022. Në këtë konkurs ka aplikuar ankuesi, mirëpo i njëjti sipas emailit të datës 04.07.2022 nga Udhëheqësi i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë është njoftuar që nuk ka plotësuar kushtet e konkursit konkretisht përvojën e punës në pozita drejtues prej pesë (5) vitesh, ndërsa ankuesi më 04.07.2022 ka kërkuar që të bëhet rivlerësimi i aplikacionit ndërsa më datë 12.07.2022 është njoftuar që është verifikuar aplikacioni mirë që nuk janë ofruar dëshmitë e mjaftueshme për përvojën e punës në pozita drejtues prej pesë (5) vitesh.

Ankuesi përmes përfaqësuesit të tij, më datë 19.07.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:4197/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së datës 12.07.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.07.2022 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Ndërsa Këshilli, më datë 29.07.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Ankuesi më datë 01.08.2022 ka parashtruar kërkesë me Nr.Prot:4434/2022, përmes të cilës ka kërkuar tërheqjen e ankesës me numër protokoll 4197/2022 të datës 19.07.2022 me arsyetimin që nuk ka interes për këtë pozitë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:4197/2022 të datës 19.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 19.07.2022; Konkursin me Nr. Reference: RN00009044 të datës 16.05.2022 për Drejtor i Përgjithshëm 2 për Shërbimin Korrektues të Kosovës; Kontratë Punësimi e datës 01.06.2008 për ankuesin; Vërtetimin për marrëdhënie punës i datës 31.05.2022 për ankuesin; Vendimin e datës 31.05.2012; Vendimin e datës 31.08.2012; Vendimin e datës 30.10.2012; Vërtetimin e lëshuar nga Ndërmarrja Private Tregtare EURONI për ankuesin; Vendimin e datës 02.07.2012; Vendimin me Nr. 54/2013 i datës 03.05.2013; Akt Emërimit për ankuesin i datës 03.05.2013; Vendimin me Nr. 65/2013 i datës 02.05.2013; Njoftimin e datës 12.07.2022 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Emailin e datës 04.07.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 04.07.2022 nga Udhëheqësi i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Kërkesën për Përgjigje në ankesë e datës 26.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 29.07.2022; Kërkesën e datës 01.08.2022 me Nr.Prot:4434/2022 e parashtruar nga ankuesi për tërheqjen e ankesës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për procedimi administrativ të filluar me ankesën e ankuesit, *sepse:*

Ankuesi më datë 19.07.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:4197/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet kundër përgjigjes së datës 12.07.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën Drejtor i Përgjithshëm 2 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, mirëpo i njëjti më datë 01.08.2022 përmes kërkesës me Nr.Prot:4434/2022 ka bërë tërheqjen e ankesës me Nr. Prot:4197/2022 të datës 19.07.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në këtë veprim të ankuesit, e në kuptim të dispozitave të nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se janë plotësuar kushtet për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar me ankesën A.nr.634/2022 të datës 19.07.2022 të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS **Lënda me numër A.nr.634/2022**

Avdyl BEKTESHI

Avdyl Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Malsore Gashi-Bajraktari
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Udhëheqësit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.